



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 431

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU SHKODËR, Z. FRROK GJIN GJINI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1072/1 prot., datë 27.03.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Benet Bahri Beci, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 69, datë 15.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 410, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese

në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës

Data: 3.5.2023 Nr: 431
Ora: 12:00



Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listen shumëmeore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër z.Frrok Gjini

25.04.2021.

Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 3 (tre) mandate.

Rezultoni se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 410, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezultoni se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 05 (pesë), z. Frrok Gjin Gjini.

Me shkresën nr. 3777 prot, datë 13.04.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, z. Frrok Gjin Gjini, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Frrok Gjin Gjini, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 18 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 4155 prot., datë 25.04.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 4193 prot., datë 25.04.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Frrok Gjin Gjini, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Frrok Gjin Gjini.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë,

z. Frrok Gjin Gjini, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Frrok Gjin Gjini, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Benet Bahri Beci, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 05 (pesë), z. Frrok Gjin Gjini.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, z. Frrok Gjin Gjini.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI